




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së dhjetë - X - të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 08.10.2021, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Ilir Hasani, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Grajçevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Naser Graiçevci.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Afrim Krasniqi - Drejtor i Administratës dhe Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 09.09.2021.
2. Propozim për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2021.
3. Propozim për rritjen e normave për punëtorë në arsim për vitin shkollorë 2021/2022.
4. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë të Noar Jahiri.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe prezantoi për shqyrtim pikën shtesë: Propozimin për rritjen e normave për punëtorë në arsim për vitin shkollorë 2021/2022.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë në konsultim me Shefat e Grupeve Parlamentare të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje dhe subjekteve tjera politike, propozoi që pikë shtesë e rendit të ditës të jetë edhe 'Propozimi për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë të fëmijut Noar Jahiri, i cili është dërguar për trajtim shëndetësorë në Turqi dhe ka një operim të kushtueshëm deri në 50,000.00€.

Pas sqarimeve dhe dakordimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, për dy pikat shtesë, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar për këtë mbledhje me pikat shtesë: Propozimin për rritjen e normave për punëtorë në arsim për vitin shkollorë 2021/2022 dhe Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë të Noar Jahiri.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar dhe dy pikat shtesë: Propozimin për rritjen e normave për punëtorë në arsim për vitin shkollorë 2021/2022 dhe Propozimin për lejin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë të Noar Jahiri.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 09.09.2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 09.09.2021, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Pasi që diskutime tjera nuk pati lidhur me përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 09.09.2021.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 09.09.2021.

Pika e dytë (2) - Propozim për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2021', ftoi Drejtorin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përschendes të pranishmit në mbledhje. Programi orientues për rritjen e grumbullimit të hyrave vetjake për vitin 2021, deri në fund të vitit është në shumë të mjeteve financiare prej: 2,280,000.00€, planifikimi buxhetor për të hyrat vetjake për vitin 2021, ka qenë në shumë të mjeteve financiare prej: 2,689,654.00€, deri më datën 26 gusht 2021 është arritur planifikimi buxhetor, ndërsa vetën deri me datën: 29.09.2021 janë grumbulluar mbi një milion euro më shumë. Në totalin e tyre grumbullimi i të hyrave vetjake këtë vitë do të jetë 4.9 milion euro. Ne propozojmë që pjesa e rritur e buxhetit të shpërndahet, në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëdijeve, shuma e mjeteve financiare prej: 29,689.88€, në arsim për mësimin jo formal, në mallëra dhe shërbime shuma e mjeteve financiare prej: 800,000.00€, prej tyre 600,000.00€ ndahen për kujdesin primarë shëndetësorë, për pagesën e personave të infektuar me sëmundjen ngjitëse Covid - 19 dhe shuma tjetër prej: 200,000.00€ ndahet për arsim, për subvencione dhe transfere shuma e mjeteve financiare prej: 450,310.12€ ndahen për shëndetësinë, arsimin, kulturën, rininë dhe sportin. Për investime kapitale ndahet shuma e mjeteve financiare prej: 1,000,000.00€, ku shuma prej: 600,000.00€ është e destinuar për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në fshatin Sllatinë e Vogël dhe shuma prej: 400,000.00€ për ndërtimin e shkollës në Fushë-Kosovë. Ju para vetës e keni, edhe propozimin tjetër për pagesën e punëtorëve në arsim, në shumë të mjeteve financiare prej 300,000.00€ që duhet të mirren nga buxheti për mallëra dhe shërbime në arsim.

Durim Hajra: Përschendes të pranishmit në mbledhje. Ne në parim jemi për rritjen e buxhetit të komunës, por nuk pajtohemi me shpërndarjen e këtij buxheti komunal, sepse këtu kemi të bëjmë

me një keqëplanifikim dhe keqëklasifikim të buxhetit. Ju vetë e theksuar se me 26 gusht është përmbushur planifikimi buxhetor, ndërsa me 29 shtator janë mbledhur një milion euro më shumë, pse këtë propozim nuk e keni dërguar për aprovim në mbledhjen e muajit shtator 2021, këtë e keni lënë qëllimshëm, për ta përdorur për fushatë elektorale, duke i shpërndarë subvencione, individëve dhe Organizatave Jo Qeveritare për vota, si dhe pacientëve të prekur me Covid - 19 në prag të zgjedhjeve.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Është sqaruar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, se deri në fund të vitit do të arrihet kjo shumë, rritje të tilla të buxhetit ne kemi patur edhe viteve të kaluara, deklarimi juaj tregon se ne do të jemi në pozitë edhe në mandatin e ardhshëm zgjedhor, por ju duhet ta kuptoni se këto mjete financiare shtesë janë të mirë se ardhura, për mbulimin e shpenzimeve në arsim dhe shëndetësi, ku kemi vështirësi me buxhetin aktual që ndahet nga niveli qendrorë, sipas rregullave buxhetore që dihen. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne pajtohemi me shpërndarjen e propozuar nga Ekzekutivi i Komunës, meqë shumica e mjeteve financiare ndahen për arsim dhe shëndetësi, andaj propozojmë aprovimin e ‘Propozimit për rritjen e buxhetit të komunës nga të hyrat vetjake për vitin 2021’.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Shpërndarja e buxhetit të komunës në shumën e mjeteve financiare prej: 2,280,000.00€, është me zero efekt për zhvillimin ekonomik dhe kjo nuk është në rregull. Kjo shpërndarje e buxhetit për subvencione, bëhet kështu me qëllime të fitimit të votave dhe është shpërndarje politike e partisë në pushtet. Një pjesë e mjeteve financiare, parashihet për ndërtimin e Palëstrës Sportive, por as sallat tjera të sportit që janë ndërtuar nuk po mirëmbahen, investimet e realizuara po dëmtohen.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne në parim jemi për rritjen e buxhetit të komunës, por për ne është i pa pranueshme aspekti kohorë, pse kjo punë po bëhet tani vetëm pak kohë para mbajtjes së zgjedhjeve, për qëllime të fushatës elektorale dhe mobilizimit të votuesve.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky tejkallim i buxhetit e don një interpretim shkencorë, këtu përveç dy mekanizmave të kontrollit financiarë që janë: auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm, të cilët mund të gjejnë defektet e planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit. Ne e dimë se grumbullimi i mjeteve financiare në tre muajt e fundit të vitit, nuk mund të shpenzohen dhe duhet të barten në vitin e ardhshëm për shpenzim, këtu është një e mirë, se këto mjete financiare do të shpenzohen në arsim dhe shëndetësi, ku nevojat për shpenzime janë më të mëdha.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne e kemi sqaruar disa herë, se si bëhet planifikimi i të hyrave vetjake, ku mirret për bazë grumbullimi i tyre në tre vitet e kaluara, ky tejkallim nuk ka të bëjë asgjë me keqëplanifikim të buxhetit dhe me shpenzimin e tij para zgjedhjeve, që u cekë nga anëtarët-ja e Kuvendit të Komunës: Durimi, Aida dhe Migjeni, këto mjete financiare nuk mund të shpenzohen tani për një javë. Mjetet financiare nga rritja e buxhetit të komunës, do të shpenzohen për realizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, për pagesën e shumës prej: 100.00€ për personat e infektuar me sëmundjen ngjitëse Covid - 19 dhe për pagesën e mësimdhënësve në arsim.

Durim Hajra: Ky vendim është puro politikë dhe për vota, ju planifikimin e buxhetit të komunës nuk e bëni si duhet, pastaj në vazhdim e bëni keqëklasifikimin e shpenzimeve, ne nuk jemi dakort me këtë shpërndarje të buxhetit.

Nënkryetari i Komunës: Planifikimi i buxhetit bëhet në bazë të kritereve që caktohen nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ne të nderuarë kemi përvojë në planifikimin e

buxhetit dhe e kemi besimin e qytetarëve për 21 vite me radhë, ky besim do të konfirmohet edhe një herë në zgjedhjet e 17 tetorit.

Migjen Kolshi: Unë i propozoi projektet publike për fshatin Harilaç dhe ato edhe pse kanë hyrë në buxhet, nuk janë realizuar. Ne nuk kemi nevojë për sqarime të tilla, sepse kjo punë është e qartë, ky buxhet shërben për vota.

Driton Ademi: Unë diskutimet e mia i them nga konteksti i opozitës, ju gjykoni vetë personalisht jam angazhuar për punë të mira, e jo si ju z. Migjen Kolshi që po dhezeni pa arsye për të fituar vota tani në kuadër të listës zgjedhore të Partisë Demokratike të Kosovës, kur jeni larguar vetë nga partia juaj bashkë me Bajram Shalën, Naser Graiçevcin e të tjerë dhe vetë me intervenim edhe të z. Jakup Krasniqi dhe z. Fatmir Limaj, keni kërkuar për të qenë pjesë e Nismës Socialdemokrate, por këtë nuk e kam lejuar unë, të anëtarësohen njerëz të tillë në partinë tonë.

Migjen Kolshi: I nderuari z. Driton Ademi, ju jeni një mashtrues tipikë, kjo që po thuani ju nuk qëndron, ne kemi patur mospajtime me qendrën e Partisë Demokratike të Kosovës dhe jemi larguar.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo praktikë e rritjes së buxhetit të komunës është për tetë vite radhazi, ku ne si Parti e Drejtësisë, kemi kërkuar arsyeshmëri për shpërndarjen e këtyre mjeteve financiare shtesë, nëpër sektorët ku ka më së shumti nevojë. Ndarja e subvencioneve po ndodh me program të njëjtë, është mirë që në buxhet parashihen 400,000.00€ për ndërtimin e shkollës dhe 600,000.00€ për ndërtimin e Palëstrës së Sporteve, do të duhet të jetë e kundërta. Mjetet financiare të parapara për shpenzime, për pagesat e personave të infektuar me sëmundjen ngjitëse Covid - 19 është e mirë, por kjo po bëhet me shumë vonesë, kur të gjithë e dimë se vitin e kaluar disa punëtorë të komunës, janë paguar me mjete financiare shtesë, përtej pagës së tyre dhe për këtë ne e kemi ngritur zërin në Kuvendin e Komunës. Te ndarja e normave për arsim kemi keqpërdorim të tyre, janë punësuar njerëz në Administratën e Komunës. Ne kërkojmë një qasje ndryshe, në planifikimin e buxhetit të komunës dhe kërkojmë ndryshime, në këtë shpërndarje të buxhetit.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Unë e sqarova se deri tani janë grumbulluar një milion euro dhe deri në fund të vitit, kur kanë mbetur edhe tre muaj, mendojmë t'i grumbullojmë edhe 1.2 milion euro, këto mjete financiare nuk mund të shpenzohen të gjitha, sepse përfundon periudha e zotimeve. Ne parashohim të fillojmë me zbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës në shumën prej: 100.00€, për pagesat e personave të prekur me Covid - 19 dhe familjarët e viktimave të Covid - 19. Për Palestrën e Sporteve e kemi një Memorandum me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili nuk është zbatuar nga Qeveria e Kosovës, kjo palestër e sportit do të ndërtohet me buxhetin e komunës.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim, 'Propozimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake, në shumë të mjeteve financiare prej: 2,280,000.00€ për vitin 2021'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe shtatë abstenime, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake, në shumë të mjeteve financiare prej: 2,280,000.00€ për vitin 2021' dhe mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2021, në shumën e mjeteve financiare prej: 2,280,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të pagave e shtesave, mallrave e shërbimeve, subvencioneve e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet e programeve, nënprogrameve dhe projekteve.

Pika e tretë (3) - Propozim për rritjen e normave për punëtorë në arsim për vitin shkollorë 2021/2022.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për rritjen e normave për punëtorë në arsim për vitin shkollorë 2021/2022', meqë deri tani nuk kemi marrë përgjigje, lidhur me shkresat e dërguara për rritjen e normave në arsim, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit dhe Ministrinë e Financave, Punës e Transfereve për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Këtë pikë e elaboruam në kuadër të 'Propozimit për rritjen e buxhetit të komunës', shuma e mjeteve financiare e planifikuar për mbulimin e 52 normave në arsim është: 296,246.40€ dhe planifikohen të shpenzohen, nga kategoria ekonomike e mallërave dhe shërbimeve tek Administrata e Arsimit.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nëse shumica e mjeteve financiare prej 296,246.40€, është e destinuar për shkollën e re unë do ta votoi propozimin në fjalë. Është dashur të bëhet një reformë në arsim dhe mësuesit nga fshatrat, ky është numri i vogël i nxënësve të vijnë në qytet. Siç e dimë normat për mësime ndahen për numrin e nxënësve.

Nënkryetari i Komunës: Ne i kemi marrë deri tani nga ish/Ministri i Financave z. Bedri Hamza, 22 norma dhe disa mësime ndahen i kemi dërguar nga fshati në qytet, por prapë kemi vështirësi sepse nevojat në qytet janë të mëdha, kemi rritje enorme të numrit të nxënësve.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne e kemi marrë një vendim më herët, tani kërkohet prapë një vendim i ri, si ka rrjedhur procedura e tenderimit të hapur për marrëveshje të veçanta me mundësi vazhdimi, apo është zhvilluar procedura e negociuar. Në arsim është e qartë se në arsim, kemi probleme të theksuara dhe nevojiten masa konkrete për zgjidhjen e çështjeve në arsim.

Migjen Kolshi: Në rastin konkret faji është i Ekzekutivit të Komunës, që ka lejuar ndërtime të larta dhe pa kritere, nuk ka menduar me kohë për shkollën, për rritjen e numrit të nxënësve, këtu është humbur besimi, sepse normat për arsim janë keqpërdorur, njerëzit janë punësuar në Administratën Komunale, pa ndonjë arsye të nevojshme për punëtorë, njëri prej tyre është nga fshati Harilaç dhe tjetra nga Komuna e Lipjanit, andaj unë për këtë arsye do të abstenoi.

Durim Hajra: Në parim ne jemi që të përkrahim arsimin, por kjo përsëritje e propozimeve herë në një mënyrë, herë në një mënyrë tjetër, e shpërfaqë mos punën me plan dhe veprimet 'ad hoc', në Drejtorinë e Arsimit. Nuk ka asnjë sqarim rekrutimi i punëtorëve po vazhdon, po keqpërdoren vendimet për fushën e arsimit, proceset e testeve po vazhdojnë, mësime ndahen po e fillojnë punën.

Nënkryetari i Komunës: Proceset në arsim janë duke u zhvilluar përmes procedurave të rregullta të konkurseve, kemi edhe raste me Covid - 19 të mësime ndahen, ata duhet të zëvendësohen.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim, 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 296,246.40€, për rritjen e normave për punëtorë në arsim për vitin shkollorë 2021/2022'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 296,246.40€, për rritjen e normave për punëtorë në arsim për vitin shkollorë 2021/2022' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 942, të datës 07.10.2021, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 296,246.40€, për 52 norma në arsim në Komunën e Fushë-Kosovës, për mësimdhënës dhe personel administrativ dhe teknik për vitin shkollorë 2021/2022, nga burimet vetjake të komunës.

Pika e katërt (4) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë të Noar Jahiri.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim shëndetësorë të fëmijut Noar Jahiri nga Fushë-Kosova'.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim, 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim shëndetësorë të fëmijut Noar Jahiri nga Fushë-Kosova'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim shëndetësorë të fëmijut Noar Jahiri nga Fushë-Kosova' dhe mori:


V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për palën Shpresa Qyqalla Jahiri, me vendlindje në fshatin Bardh i Madh të Fushë-Kosovës, me destinim për të ndihmuar në shërimin shëndetësorë dhe trajtimin e djalit të saj Noar Jahiri, i cila vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Atrofi Progressive Parenkimale Amaurosis Epi.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:20 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

